



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
DREJTORIA E SHËRBIMEVE QEVERTARE

NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE

Tiranë më 15.04.2026

Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare është Person juridik në varësi të Këshillit të Ministrave, e cila vepron në përputhje me ligjin Nr. 7582, datë 13.07.1992 “Për Ndërmarrjet Shtetërore” i ndryshuar, si dhe VKM-së Nr. 34, datë 07.01.1999, “Për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare dhe Trajtimin e Personaliteteve të Larta Shtetërore” i ndryshuar. Në zbatim të Vendimit Nr. 744 datë 12.12.2025 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve dhe punonjësve të Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare”, të Urdhrit të Kryeministrit Nr. 226 datë 12.12.2025, “Për Miratimin e Organikës së Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare”, si dhe të Rregullores së Brendshme të DSHQ-së, njofton hapjen e konkurrimit për vend të lirë pune si vijon:

Të dhënat për pozicionin e punës:

Emërtesa e pozicionit:	Specialist Transporti (1 vend)
Institucioni:	Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare
Drejtoria:	Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse
Spektori:	Spektori i Transportit
Kategoria e pagës:	IV-1

Përshkrimi përgjithshëm i pozicionit të punës:

Specialisti i transportit është përgjegjës për planifikimin, koordinimin dhe monitorimin e përdorimit të mjeteve të institucionit, me qëllim garantimin e funksionimit efikas të shërbimit të transportit. Organizon shpërndarjen e detyrave për shoferët në përputhje me nevojat operative, siguron gatishmërinë dhe vendosjen në dispozicion të mjeteve sipas kërkesave, si dhe ndjek gjendjen e tyre teknike. Në kuadër të përgjegjësive, specialisti mban evidencë të plotë mbi përdorimin e mjeteve, përfshirë kilometrat, konsumin e karburantit dhe dokumentacionin përkatës, si dhe përgatit kërkesa dhe specifikime për mirëmbajtjen dhe furnizimin me materiale. Gjithashtu, ndjek dhe përpunon dokumentacionin financiar dhe administrativ që lidhet me shërbimet e transportit, përfshirë ato për delegacione dhe palë të treta. Specialisti raporton në mënyrë të vazhdueshme mbi ecurinë e punës dhe problematikat e hasura tek eprori i drejtpërdrejtë, si dhe zbaton çdo detyrë tjetër të ngarkuar në funksion të realizimit të objektivave të sektorit.

Kandidatët duhet të plotësojnë:

Kërkesat e përgjithshme të pozicionit të punës si vijon:

- a. Të jenë shtetas shqiptar;
- b. Të kenë zotësi të plotë për të vepruar;
- c. Të zotërojnë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d. Të përmbushin kërkesat ligjore për nivelin arsimor dhe të zotërojnë aftësitë e nevojshme dhe profesionale për vendin e punës;
- e. Të jenë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse
- f. Të mos jenë të dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen një kundërvajtjeje penale me dashje;
- g. Të mos jenë marrë ndaj tyre masa disiplinore, që nuk është shuar sipas ligjit;

Kërkesat e veçanta të pozicionit të punës si vijon:

- a. Të zotërojnë diplomë të nivelit Master profesional/ Master Shkencor apo Master profesional të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike, e preferueshme në fushat: Logjistikë, Menaxhim, Ekonomi, Inxhinieri, Shkenca Aplikuese ose fusha të ngjashme. (Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).
- b. Të kenë jo më pak se 1 vit përvojë pune.
- c. Të kenë aftësi të mira komunikuese, menaxhimi dhe të punës në grup.
- d. Të zotërojnë gjuhën të huaj. Përparësi ka një gjuhë e dytë e BE-së.
- e. Kualifikime: përbëjnë avantazh;

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentacionin, si më poshtë:

1. Kërkesë për punësim.
2. Jetëshkrim (CV)
3. Fotokopje të diplomës dhe listës së notave (Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit)
4. Fotokopje të librezës së punës (*të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë*);
5. Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
6. Certifikatë familjare
7. Vërtetim të gjendjes shëndetësore,
8. Vërtetim të gjendjes gjyqësore (Dëshmi Penaliteti) ose Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
9. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Mosdorëzimi i dokumenteve të mësipërme dhe mosplotësimi i kritereve, e s'kualifikojnë automatikisht aplikantin.

- Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve të cituara më sipër, paraqiten pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore të Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare, me adresë: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Pallati i Kongreseve, Kati i III-të, Tiranë, ose në adresën elektronike burimet.njerezore@dshq.gov.al
- Afati përfundimtar për dorëzimin e aplikimit dhe dokumentacionit të sipërcituar është brenda datës: **22.04.2026** (afati i fundit i aplikimit).
- Pas përfundimit të procesit të shqyrtimit të aplikimeve dhe vlerësimit të dokumentacionit, Njësia e Burimeve Njerëzore do të njoftojë individualisht, nëpërmjet e-mail-it zyrtar, kandidatët e kualifikuar për vijimin e fazave të mëtejshme të konkurrimit.